



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 17.10.2018

RAPORT

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË FINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI
DHE KOMISIONIT EVROPIAN, PËR PROGRAMIN E VEPRIMIT
TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA II, MALI I ZI - SHQIPËRI,
ALOKIMET E VITIT 2016”**

- HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 17 tetor 2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, alokimet e vitit 2016”. Komisioni caktoi si relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Jurgis Çyrbja. Komisioni e shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të paraqitur projektligjin, në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji, nismë e Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, si dhe në nenin 18 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, alokimet e vitit 2016.

Programi i bashkëpunimit Mal i Zi - Shqipëri ka për qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin social-ekonomik të zonave ndërkufitare dhe të rrisë bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta. Ky program mbështet gjithashtu shkëmbimin e eksperiencës dhe të njohurive ndërmjet përfituesve, si dhe përmirësimin e politikave publike mes autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale në zonën e programit.

Programi do të fokusohet në prioritetet e mëposhtme:

- 1. Nxitja e turizmit dhe e trashëgimisë kulturore dhe natyrore;*
- 2. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut;*
- 3. Nxitja e punësimit, lëvizjes gjeografike të punonjësve dhe përfshirjes sociale e kulturore përtej kufirit.*

Përfitues të këtij programi për Shqipërinë do të jenë zonat e Shkodrës, Lezhës, dhe Rrethi i Tropojës.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

- Në aspektin ligjor** projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi me votat e shumicës së anëtarëve dhe vendosi t'ia kalojë për miratim seancës plenare.

RELATORI

Jurgis ÇYRBJA

KRYETARI

Ulsi MANJA